



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

RAPORT VJETOR I MONITORIMIT/ZBATIMIT TË PLANIT TË
INTEGRITETIT

MINISTRIA E MBROJTJES
2025

Përmbajtja:

Përmbledhje ekzekutive	2
Qasja vlerësuese.....	4
Metodologjia e vlerësimit	4
GJETJET E RAPORTIT	5
Objektivi 1: Përmirësimi i procesit të politikave dhe mekanizmave të kontrollit dhe mbikëqyrjes demokratike	5
Objektivi 2: Përmirësim i procesit të menaxhimit të burimeve njerëzore nëpërmjet forcimit të kapaciteteve dhe rritjes së transparencës dhe llogaridhënies	8
Objektivi 3: Fusha e auditimit të brendshëm dhe kontrolli.....	12
Objektivi 4: Transparencë proaktive e përmirësuar për të gjithë fazat e procesit të prokurimit publik.....	13
Objektivi 5: Politikë e përmirësuar për adresimin e rreziqeve të integritetit në operacione dhe ndërgjegjësim i plotë i të gjitha niveleve drejtuese dhe komanduese të FA-së mbi këto rreziqe.	14
Konkluzione dhe rekomandime	16

Përmbledhje ekzekutive.

Ndërtimi i integritetit është një aspekt i rëndësishëm i funksionimit të demokracive dhe një shtyllë e rëndësishme e shtetit të së drejtës. Korrupsioni ndikon shumë në besimin e publikut, dëmton rëndë efektivitetin e institucioneve dhe cenon legjitimitetin demokratik të tyre. Lufta kundër korrupsionit është prioritet i qeverisë shqiptare.

Në kontekstin e sektorit publik, integriteti konsiston në përmbushjen e detyrimeve të: transparencës, llogaridhënies, etikës, ndershmërisë, efektivitetit dhe eficiencës në përmbushjen e detyrave dhe të ushtrimit të funksioneve rregullatore dhe administrative.

Ministria e Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, hartoi dhe miratoi Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit në Institucionet e Qeverisjes Qendrore, miratuar me urdhrin e ministrit të Drejtësisë nr. 334, datë 07.10.2020 dhe Instrumentin e Monitorimit të Planit të Integritetit në Institucionet e Qeverisjes Qendrore, miratuar me urdhrin e ministrit të Drejtësisë nr. 553, datë 30.09.2021.

Ministria e Mbrojtjes ka hartuar “Planin e Integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes 2022-2025 dhe Planin e Veprimt 2024, miratuar nga ministri i Mbrojtjes, me urdhër nr. 516, datë 19.04.2022.

Plani është hartuar duke u mbështetur në Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit për Institucionet e Qeverisjes Qendrore, të miratuar nga Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit, të Pyetësorit të Vetëvlerësimit të Ndërtimit të Integritetit të NATO-s dhe të Indeksit Qeveritar të Integritetit të Mbrojtjes të Transparency International.

Zhvillimi dhe hartimi i Planit të Integritetit është kryer nga grupi i punës për hartimin e Planit të Integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes (i përbërë nga përfaqësues nga Drejtoria e Monitorimit dhe Jetësimit të Prioriteteve, Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, Drejtoria e Auditimit, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Prokurimeve dhe Ankandeve, Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore, Drejtoria e Inspektimit të Përgjithshëm, si dhe nga Sektori i Sekretarisë, Arkiv, Protokollit dhe Nënregjistrimit të NATO-s), gjatë periudhës dhjetor 2021 - mars 2022. Gjithashtu, janë përfshirë edhe përfaqësues nga struktura të tjera jashtë grupit të punës, si nga Drejtoria e Mirëadministrimit dhe Pronave dhe Aseteve.

Hartimi i Planit të Integritetit u realizua me asistencën teknike të Qendrës për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes, të Mbretërisë së Norvegjisë (CIDS). Plani i Integritetit parashikon gjithashtu krijimin e mekanizmit të zbatimit dhe të monitorimit dhe vlerësimit për të matur progresin e arritur.

Koordinatori i Integritetit për Ministrinë e Mbrojtjes miratoi “Planin e aktiviteteve për zbatimin e Planit të Integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes për periudhën 2022-2025”, i cili u përgatit në konsultim me drejtoritë dhe strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, që parashikonte detyra specifike për drejtoritë dhe strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Plani i aktiviteteve synon përcaktimin e hapave që do të ndiqeshin nga strukturat, si dhe treguesit e zbatimit, të cilat do të shërbenin për të vlerësuar shkallën e realizimit të masave, aktiviteteve dhe objektivave të përcaktuar në Planin e Veprimit gjatë procesit të monitorimit.

Në këtë mënyrë, Plani i Integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes siguron përfshirjen e konceptit të integritetit në aspektet kryesore të punës së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura, duke i ndërlidhur ato me “Qeverisjen e Mirë, Demokracinë, dhe Shtetin e së Drejtës”, që përbën një nga shtyllat kryesore të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim.

Nisur nga sa më sipër, objektivat strategjikë të Planit të Integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes 2022-2025 janë:

1. Përmirësimi i procesit të politikave dhe mekanizmave të kontrollit dhe mbikëqyrjes demokratike.
2. Rritja e transparencës dhe llogaridhënies së Ministrisë së Mbrojtjes.
3. Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore.
4. Forcimi i mekanizmave të kontrollit të brendshëm.
5. Forcimi i integritetit në operacione dhe misionet ndërkombëtare.
6. Përmirësimi i sistemeve të menaxhimit të aseteve.

Plani i Integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes është një instrument i luftës kundër korrupsionit, i cili ka të parashikuar masa të identifikuar në 5 fusha të përgjegjësisë institucionale të ministrisë. Plani i Integritetit për vitin 2024 ka qenë vijim i realizimit të projekteve të planifikuara gjatë periudhës 2022-2025 dhe përmban gjithsej 25 masa të karakterit rregullator e operacional, për të cilat janë parashikuar ndërhyrje (aktivitete) përkundrejt çdo risku të evidentuar.

Njësitë përgjegjëse për zbatimin e tyre ishin drejtoritë dhe strukturat e vartësisë së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, si dhe grupe institucionale pune. Afati i zbatimit dhe realizimit të këtij Plani të veprimit të Planit të Integritetit ishte periudha 1 janar - 31 dhjetor 2024.


Në përputhje me kreun 1, pika 1.2, të Planit të veprimit të Planit të Integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe me Metodologjinë e Monitorimit të Planit të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore, si dhe shkresës me nr. 1103, datë 19.02.2025, të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Ministria e Mbrojtjes gjatë muajit mars 2025, në bashkëpunim me drejtoritë dhe strukturat e vartësisë së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, hartoi këtë raport vjetor monitorimi mbështetur në të dhëna të verifikueshme dhe transparente.

Raporti i monitorimit vjetor jep të dhëna për objektivat dhe masat institucionale të parashikuara në Planin e Integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2024 dhe statusin e zbatimit të tyre, problematikat e hasura në zbatimin e tyre, si dhe përmban të dhëna për veprimtarinë operationale të njësive (drejtorive) të brendshme kontribuese, referuar hartimit dhe plotësimit të kuadrit

rregullator të brendshëm, burimeve njerëzore dhe profesionale, si dhe transparencën dhe komunikimin me grupet e interesuara.

Për periudhën një vjeçare (1 janar - 31 dhjetor 2024), në Planin e Integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes ishin parashikuar për zbatim 25 masa dhe 31 aktivitete, në realizim të vizionit dhe objektivave të mësipërme.

Nga procesi i monitorimit rezulton se në totalin prej 25 masash të parashikuara për zbatim në periudhën 1 janar -31 dhjetor 2024: janë përmbushur plotësisht 25 masat e parashikuara në Planin e Integritetit 2024, dhe nuk rezulton asnjë masë e pazbatuar.



Qasja vlerësuese.

Raporti i monitorimit vjetor të zbatimit të Planit të Integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2024 përmban një analizë të përgjithshme të performancës institucionale për t'i rezistuar shkeljeve të integritetit, si dhe çështje të transparencës institucionale në luftën kundër korrupsionit.

Metodologjia e vlerësimit.

Ky raport është hartuar në bazë të kontributit të drejtorive dhe strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, të një grupi të brendshëm pune dhe të Koordinatorit të Integritetit. Raporti vjetor i monitorimit për vitin 2024 përmban një analizë sintezë cilësore dhe sasiore të kontributit të tyre.

Analiza cilësore e këtij raporti bazohet në vlerësimin institucional të kuadrit organizativ, funksional dhe operacional të tyre. Analiza sasiore e këtij raporti vjetor bazohet në vlerësimin e të dhënave statistikore të strukturave/njësive kontribuese.

Mbledhja dhe analiza e të dhënave.

Të dhënat e këtij raporti janë grumbulluar nga Koordinatori i Integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes, në përmbushje të rolit të tij, si struktura e posaçme përgjegjëse për mbledhjen, analizën e

informacionit, si edhe për hartimin e raportit të monitorimit. Koordinatori i Integritetit i raporton titullarit të institucionit mbi ecurinë e zbatimit të Planit të Integritetit.

Titullari i institucionit merr masa për garantimin e zbatimit të Planit të Integritetit dhe adresimin e problematikave të dala nga drejtoritë dhe strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjatë procesit të monitorimit.

Këto të dhëna janë raportuar nga përfaqësuesit e njësive kontribuuese në këtë raport, të cilat janë: Drejtoria e Monitorimit dhe Jetësimit të Prioriteteve, Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore, Drejtoria e Auditimit, Qendra Kulturore e Medias dhe Botimeve të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe Shtabi i Përgjithshëm i FA-së.

Mbledhja e informacionit nga këto njësi është kryer nëpërmjet plotësimit të aneksit të këtij raporti. Secila njësi ka raportuar mbi: hapat e ndërmarrë dhe statusin e realizimit të tyre për çdo masë të parashikuar për zbatim për vitin 2024; akte dhe dokumente të hartuara; rekomandime dhe konkluzione. Draft-raporti i hartuar është konsultuar me njësitë përgjegjëse për zbatim dhe raportim. Përpara publikimit, raporti është miratuar nga ministri i Mbrojtjes.

GJETJET E RAPORTIT

Objektivi 1: Përmirësimi i procesit të politikave dhe mekanizmave të kontrollit dhe mbikëqyrjes demokratike.

Përmes këtij objektivi synohet pjesëmarrja në hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e politikave të mbrojtjes dhe sigurisë të një sërë aktorëve, qofshin institucione shtetërore apo media, grupe interesi dhe shoqëri civile në përgjithësi, duke garantuar që politikat dhe vendimet në lidhje me mbrojtjen të jenë të qëndrueshme dhe në përputhje me nevojat strategjike, dhe që problemet të mund të identifikohen që në një fazë të hershme.

Objektivi 1 përmban një numër prej 6 masash specifike të planifikuara për t'u zbatuar nga njësitë e përfshira për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2024, nëpërmjet 10 aktiviteteve kryesore. Njësitë raportuese për këtë objektiv janë strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave të Mbrojtjes.

Gjatë periudhës raportuese një vjetore rezulton se janë realizuar plotësisht masat e parashikuara (produktet), si dhe nga monitorimi përfundimtar rezulton se janë kryer të gjitha aktivitetet, sipas tabelës më poshtë:

Objektivi 1	Masat dhe aktivitetet	Realizimi i masave dhe aktiviteteve			
		Masa të parashikuara dhe plotësisht të realizuara për vitin 2024	Masa të përealizuara për vitin 2024	Aktivitete të parashikuara dhe plotësisht të realizuara për vitin 2024	Aktivitete të përealizuara për vitin 2024
Përmirësimi i procesit të politikave dhe mekanizmave të kontrollit dhe mbikëqyrjes demokratike	Masa/ Aktivitete	6	0	10	0



Në mënyrë më të detajuar gjatë monitorimit për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2024, masa 1.1 e përfshirjes në dokumentet e politikave të Ministrisë së Mbrojtjes të një kuadri orientues për veprimtarinë kundër korrupsionit në sektorin e mbrojtjes, rezulton e realizuar 100 %, me përfshirjen në Direktivën të Mbrojtjes 2025, e miratuar nga ministri i Mbrojtjes e cila është e aksesueshme në linkun <https://www.mod.gov.al/images/politikat/2025/direktiva-mbrojtjes-2025-compressed.pdf>, sipas vizionit të Planit të Integritetit për një sektor mbrojtjeje që ruan integritetin dhe refuzon korrupsionin, duke institucionalizuar standardet dhe parimet më të larta të mirëqeverisjes.

Masa 1.2, e cila ka si objektiv “Kryerjen e rivlerësimit të rrezikut të integritetit/korrupsionit në MM”, si dhe parashikon zhvillimin e 5 aktiviteteve që përfshijnë që nga ngritja dhe funksionimi i grupe, trajnimin, identifikimin dhe vlerësimin e riskut, si dhe hartimin e planit të integritetit, është e realizuar 100 %.

Në zbatim të kësaj mase, Drejtoria e Përgjithshme të Politikave të Mbrojtjes në MM ka ndjekur dhe ka zbatuar të gjitha detyrimet për koordinimin me SHPFA-në, Drejtorinë e Përgjithshme dhe Antikorrupsionit në Ministrinë e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, si dhe Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim për organizimin e trajnimeve dhe hartimin e planit të integritetit të SHPFA-së.

Në zbatim të këtij objekti, SHPFA-ja ka hartuar dhe miratuar Planin e Integritetit, si dhe mënyrën e monitorimit dhe raportimit vjetor të monitorimit. Kjo masë është plotësisht e realizuar 100%.

Lidhur me masën 1.4, që përshkruan “Mungesën e harmonizimit të dokumenteve strategjike në sektorin e mbrojtjes”, ku parashikohej hartimi i një dokumenti të brendshëm mbi procesin e planifikimit në MM dhe FARSH, kjo masë është e realizuar 100% nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Mbrojtjes në Ministrinë e Mbrojtjes.

Për më shumë informacion në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes gjendet e publikuar urdhri nr. 129, datë 31.01.2024, i ministrit të Mbrojtjes, “Për miratimin e “Rregullores për planifikimin, harmonizimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura”, i cili gjendet i aksesueshëm në linkun: <https://mod.gov.al/images/politikat/2024/strategji/regullore-planifikimit-harmonizimit-compressed-150224.pdf>. Kjo masë është plotësisht e realizuar 100%.

Lidhur me masën 1.5, e cila parashikon hartimin e një dokumenti kuadër mbi angazhimin e palëve të interesuara gjatë hartimit të dokumenteve mbi politikën e mbrojtjes, publikimin dhe diskutimin e raporteve, ky proces është realizuar gjatë hartimit të SKZHI-së, më datë 24.6.2022 dhe vijon të zbatohet gjatë hartimit të dokumenteve të tjera të politikave të mbrojtjes, si dhe gjatë takimeve të konsultimit publik.

Për më tepër, është institucionalizuar dhe normuar ky hap, me miratimin e urdhrin të ministrit të Mbrojtjes nr. 222, datë 19.02.2024, “Për krijimin e Komisionit të Konsultimit Publik dhe procesin e konsultimit në hartimin dhe miratimin e politikave dhe çështjeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë”.

Në vijim të këtij procesi dhe zbatim të Planit të Integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014, “Për të drejtën e Informimit”, në datën 7 shkurt 2024, u zhvillua takimi për konsultimin publik mbi çështje të sigurisë kombëtare.

Gjithashtu, në kuadër të rishikimit të Strategjisë Ushtarake dhe Planit Afatgjatë të Zhvillimit 2024-2033, në datë 16 prill 2024, në ambientet e Ministrisë së Mbrojtjes u zhvillua takimi i dytë konsultativ për këto dy dokumente strategjike.

Të gjithë dokumentet që i nënshtrohen konsultimit publik në Ministrinë e Mbrojtjes i gjeni të publikuara në linkun: <https://www.mod.gov.al/index.php/konsultim-publik>. Kjo masë është përmbushur plotësisht 100%.

Lidhur me masën 1.7, mbi “Mungesën e vlerësimit të nevojës për hartimin e një Plani Integriteti në strukturat e varësisë të Ministrisë së Mbrojtjes”, të cilat plotësonin kriteret për të pasur një plan integriteti, ky proces gjatë vitit 2024 është realizuar 100% nga të gjitha institucionet, si dhe në

vazhdimësi u bashkëpunua mbi hartimin e raportit vjetor të monitorimit nga strukturave të vartësisë së MM-së dhe SHPFA-së.

Në zbatim të kësaj mase, gjatë vitit 2024 kemi ndjekur në mënyrë sistematike ecurinë e procesit mbi vlerësimin e riskut të integritetit, gjetjen e instrumenteve për forcimin e integritetit, duke zhvilluar trajnime mbi mënyrën e monitorimit dhe zbatimit të planit, si dhe u dhanë udhëzime mbi zhvillimin e procesit të realizimit të masave të caktuara. Më konkretisht, në MM gjenden të publikuara Plani i Integritetit nga strukturat, si më poshtë:


- SHPFA, Planin e Integritetit, i cili gjendet i publikuar në faqen zyrtare të internetit në linkun: <https://aaf.mil.al/publikime-doktrimore/7001-ndertimi-i-integritetit-te-shpfa>.
- Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, Plani i Integritetit për vitin 2024-2025 gjendet i publikuar në linkun: <https://dprms.gov.al/plani-i-integritetit-2024-2025/>;
- Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Plani i Integritetit për vitin 2024-2026 gjendet i publikuar në linkun: <https://akmc.gov.al/wp-content/uploads/2024/02/Plani-i-Integritetit-i-AKMC-2024-2026.pdf>;
- Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes, Muzeut të Forcave të Armatosura për vitin 2022-2025, gjendet i publikuar në linkun: <https://www.mod.gov.al/ministria-2/strukturat-vartese/2017-04-21-11-26-45/6368-ndertimi-i-integritetit-i-qkmbmmfa>;
- Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, Plani i Integritetit për vitin 2024-2025 gjendet i publikuar në linkun: <https://www.akshe.gov.al/2023/12/13/plani-i-integritetit-autoritetit-tekontrollit-shteteror-te-eksporteve-2022-2025/>.
- Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake, Plani i Integritetit për vitin 2022-2025 gjendet i publikuar në linkun: <https://www.mod.gov.al/images/transparenca/igjiu/2024/Plani-i-Integritetit-IGJIU.pdf>.

Kjo masë është përmbushur plotësisht nga SHPFA, QKMBMMFA-ja, AKMC-ja, AKSHE-ja, DRMSH-ja dhe IGJIU-ja. Kostoja e këtyre masave ishte administrative dhe e pjesë e planifikimit buxhetor të brendshëm të vitit 2024.

Objektivi 2: Përmirësim i procesit të menaxhimit të burimeve njerëzore nëpërmjet forcimit të kapaciteteve dhe rritjes së transparencës dhe llogaridhënies.

Ky objektivi përmbante një numër prej 10 masash specifike dhe 12 aktivitete të planifikuara për t'u zbatuar për vitin 2024 nga njësitë e përfshira. Nga mbledhja e raportimeve nga strukturat përgjegjëse për zbatimin e kësaj mase rezultoi se kjo masë vijon të ngelet e realizuar në masën 95%.

Objektivi 2	Masat dhe aktivitetet	Realizimi i masave dhe aktiviteteve			
		Masa të parashikuara dhe plotësisht të realizuara për vitin 2024	Masa të përcaktuara për vitin 2024	Aktivitete të parashikuara dhe plotësisht të realizuara për vitin 2024	Aktivitete të përcaktuara për vitin 2024
Përmirësim i procesit të menaxhimit të burimeve njerëzore nëpërmjet forcimit të kapaciteteve dhe rritjes së transparencës dhe llogaridhënies	Masa/ Aktivitete	10	0	11	1



Aktivitetet e këtij objekti i referohen specifiku forcimit të kapaciteteve profesionale me organizimin e trajnimeve për politikën e privatësisë, rishikimin e përkrahjeve të punës, duke përfshirë detyrat që burojnë nga ligjet e veçanta në to, përfshirjen në trajnime për procesin e njoftimit dhe konsultimit publik, si dhe trajnimin e rregullt në lidhje me antikorrupsionin.

Gjatë monitorimit për vitin 2024 rezultoi se objektivi 2 i Planit të Integritetit, masa 2.1, e cila evidenton “Mungesën e procedurave standarde të veprimit”, kërkon evidentimin e strukturave që nuk kanë procedurë standarde veprimi dhe marrjen e masave për hartimin dhe miratimin e procedurave standarde të veprimit për secilin proces pune në MM.

Realizimi i kësaj mase u ndoq me prioritet maksimal nga Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në MM, si drejtori përgjegjës në ndjekjen e këtij procesi, në bashkëpunim me strukturat e tjera në MM. Në zbatim të kësaj mase Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në MM realizoi procesin e evidentimit

të procedurave standarde të veprimit ekzistuese, si dhe mori të gjitha masat e nevojshme për hartimin, draftimin dhe miratimin e procedurave standarde të veprimit për secilin proces pune në MM.

Nga raportimet e grumbulluara për vitin 2024 rezulton se 60% e strukturave në MM disponojnë procedura standarde të veprimit. Duke qenë se procesi i hartimit të procedurave standarde të veprimit është një proces kompleks dhe i vazhdueshëm, gjatë vitit 2024 strukturat përgjegjëse në MM punuan në mënyrë të pandërprerë për realizimin në përfundim të vitit 2024, në masën 80%.

Aktualisht Strategjia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore 2025 - 2029 është në proces rishikimi e përditësimi. Krahas kësaj, po punohet me përditësimin e procedurave të tjera standarde në lidhje me menaxhimin e personelit civil, i cili nuk gëzon statusin e nëpunësit civil. Kjo masë është realizuar në masën 80%.

Për sa i përket masës 2.1, 2.2, 2.3, 2.4, 2.5 dhe 2.8, të përcaktuara në objektivin 2, të cilat kanë si prioritet hartimin e planit vjetor për trajnime për të gjithë stafin e MM-së, lidhur me politikat e privatësisë, konfliktin e interesit dhe hartimin dhe miratimin e metodologjisë së VNT-së, Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në MM, në bashkëpunim me institucionet e tjera përgjegjëse në fillim të vitit 2024, hartoi një plan kalendar vjetor të nevojave për trajnime mbi politikat e privatësisë për MM-në, e cila iu dërgua ASPA-s.

Në këtë plan kalendar vjetor ishin planifikuar dhe detajuar të gjitha trajnimet vjetore të domosdoshme për nëpunësit civilë të MM-së, AKMC-së dhe DPRMSH-së për çështjet e politikave të privatësisë dhe konfliktit të interesit.

Në mënyrë të veçantë vlen të përmendim se Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, në bashkëpunim me Drejtorinë e Personelit në SHPFA, ku çdo fillim viti harton planin vjetor të zhvillimit të kurseve funksionale dhe institucionale për çdo vit kalendarik. Pas miratimit nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, plani u dërgohet zyrtarisht të gjitha strukturave të MM-së dhe FA-së.

Në këtë plan parashikohet gjithashtu përfshirja e trajnimit për konfliktin e interesit, e cila është pjesë e planin vjetor të trajnimeve të ofruara vetëm nga ASPA për personelin civil me status të nëpunësit civil. Për personelin civil që nuk gëzon statusin e nëpunësit civil, si dhe për personelin ushtarak, aktualisht nuk ofrohen kurse/trajnime as nga vendet aleate/partnere për këtë fushë. Kjo masë është realizuar në masën 100%.

Në lidhje me masën 2.6 “Mungesa e një regjistri dhuratash, deklaratën e konfidencialiteti dhe dypunësimi, e cila parashikon rishikimin e rregullores së brendshme dhe draftimin e kodit të dhuratave”, pjesë e të cilit të bënte pjesë dhe regjistri i dhuratave, si dhe deklarata për marrjen e një dhurate, Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në MM ka realizuar në masën 100% detyrimet që rrjedhin nga masa 2.6, duke përgatitur dhe duke miratuar regjistrin e dhuratave, me urdhrin nr. 167, datë 8.2.2023, “Për miratimin e regjistrit të dhuratave”, i cili gjendet i publikuar në linkun e mëposhtëm.

Për sa i përket masës 2.7, që parashikon përfshirjen në përkrahjet e punës të detyrave që burojnë nga ligje të veçanta, si: ligji për të drejtën e informimit, ligji për mbrojtjen e të dhënave personale, ligji për konfliktin e interesit të jenë pjesë e përkrahjet të punës për punonjësit që kryejnë këto detyra, në raportin vjetor të përgatitur nga Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në MM, ky proces do të kryhet vetëm në rastet e ristrukturimit dhe do të merret parasysh si masë.

Në lidhje me masën 2.8, që parashikon “Hartimin e një programi të dedikuar trajnimesh për “Informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, si dhe draftimi i një procedure standarde veprime lidhur me trajtimin e rasteve të informacionit të klasifikuar”, Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, në bashkëpunim me Drejtorinë e Zbulimit J-2 në SHPFA, si dhe Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (AISM), gjatë vitit 2024, kanë vijuar bashkëpunimin dhe koordinimin për përgatitjen e planit vjetor të nevojave për trajnim të stafit të MM-së, lidhur me informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, si dhe në vijim të këtij procesi kanë realizuar trajnime me personelin e MM/SHPFA-së. Kjo masë e parashikuar në objektivin 2, pika 2.8 është realizuar 100%.

Lidhur me masën 2.9, e cila përshkruan “Mungesën e trajnimeve për procesin e njoftimit dhe konsultimit publik”, për vitin 2024, koordinatori për konsultimin publik në MM ka marrë pjesë në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha trajnimet për punonjësit e konsultimit publik, lidhur me procesin e konsultimit publik.

Trajnimi në lidhje me proceset e konsultimeve publike; të gjitha fazat e konsultimit publik sipas ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik” dhe udhëzuesit të miratuar me urdhrin nr. 3/2021, të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, zhvillohen në mënyrë periodike. Kjo masë e parashikuar në objektivin 2, pika 2.9 për gjashtëmujorin e parë të vitit 2024, është realizuar 100%.

Lidhur me masën 2.10, “Mungesa e trajnimit të rregullt në lidhje me antikorrupsionin dhe integritetin për gjithë personelin”, Ministria e Mbrojtjes gjatë vitit 2024 hartoi një kurrikul trajnimi. Për vitin 2024 u hartua plani i nevojave për trajnim, ku u përcaktua dhe trajnimi i stafit të MM-së, lidhur me antikorrupsionin.

Gjithashtu, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga masa 2.10, e objektivit 2, në datën 22 korrik morëm pjesë në një takim të dedikuar konsultativ nën drejtimin e Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin me pjesëmarrjen e të gjitha institucioneve që kanë dhënë kontributin e tyre të rëndësishëm në hartimin e projekt-dokumentit. Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, inicioi procesin për konsultim publik të Draft-Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024 - 2030.

Gjithashtu, kemi marrë pjesë në mbledhjen e Grupit Tematik Antikorrupsion, drejtuar nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, më datë 23 maj 2024.


Në zbatim të rekomandimeve të Drejtorisë së Programeve dhe Projekteve Antikorrupsion në Ministrinë e Drejtësisë, nga data 10-14.06.2024 kemi marrë pjesë në një cikël workshope për vlerësimin e riskut të integritetit në administratën publike, si dhe hartimin dhe monitorimin e instrumenteve të integritetit. Projekti “Forcimi i Integritetit për Përmirësimin e Shërbimeve Publike” zbatohet nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim dhe financohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëveprim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA).

Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga masa 2.10, MM-ja ka përcaktuar nevojat për trajnim, si dhe ka hartuar një kurrikul, e cila iu përcoll ASPA-s, për vijimin e bashkëpunimit në fushën e antikorrupsionit. Dokumentin me subjekt “Strategjia e menaxhimit të burimeve njerëzore 2020-2024 në MM”, mund ta gjeni në linkun: <https://www.mod.gov.al/images/PDF/2020/Strategjia-e-Menaxhimit-2020-2024.pdf>. Kjo masë e parashikuar në objektivin 2, pika 2.9, për vitin 2024 është realizuar 100%. Kostoja e këtyre masave është administrative dhe e pjesë e planifikimit buxhetor të brendshëm.

Objektivi 3: Fusha e auditimit të brendshëm dhe kontrolli

Ky objektivi për vitin 2024 përmbante një masë dhe një aktivitet.

Objektivi 3	Masat dhe aktivitetet	Realizimi i masave dhe aktiviteteve			
		Masa të parashikuara dhe plotësisht të realizuara për vitin 2024	Masa të përcaktuara për vitin 2024	Aktivitetet të parashikuara dhe plotësisht të realizuara për vitin 2024	Aktivitetet të përcaktuara për vitin 2024
Fusha e auditimit të brendshëm dhe kontrolli	Masa/ Aktivitete	1	0	1	0




Në masën 3.1 parashikohet përfshirja e trajnimeve të auditimit të performancës në planin vjetor të trajnimeve. Në lidhje me këtë masë për vitin 2024, është zhvilluar një trajnim për auditin e performancës në shkurt 2024. Lidhur me publikimin e raporteve të auditit, Drejtoria e Auditimit disponon raportin vjetor 2024 të veprimtarisë së Auditit të miratuar nga ministri i Mbrojtjes. Trajnimin në fushën e performancës së auditit, trajnimi është realizuar në fillim të vitit 2024 (5 ditë) me të gjithë stafin e Drejtorisë së Auditimit. Kjo masë konsiderohet e përbushur 100%.

Objektivi 4: Transparencë proaktive e përmirësuar për të gjithë fazat e procesit të prokurimit publik.

Ky objektiv përmban 3 masa dhe 3 aktivitete të planifikuara.

Objektivi 4	Masat dhe aktivitetet	Realizimi i masave dhe aktiviteteve			
		Masa të parashikuara dhe plotësisht të realizuara për vitin 2024	Masa të përealizuara për vitin 2024	Aktivitete të parashikuara dhe plotësisht të realizuara për vitin 2024	Aktivitete të përealizuara për vitin 2024
Transparencë proaktive e përmirësuar për të gjithë fazat e procesit të prokurimit publik	Masa/ Aktivitete	5	0	5	0



- Në masën 4.1 parashikohet pjesëmarrja në trajnime për koordinatorin e riskut. Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore bashkëpunoi me ASPA-n në mënyrë shkrese, duke i dërguar një kurrikul në të cilën përfshiheshin të gjitha nevojat për realizimin e trajnimeve.

Kjo masë është në proces realizimi të vazhdueshëm dhe koordinatori i riskut merr pjesë në të paktën një trajnim në vit.

- Në masën 4.2, Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve gjatë realizimit të detyrave lidhur me procesin e rekrutimit, gjatë vitit 2024, ka mundur në kohë dhe cilësi plotësimin e vakancave për personelin financiar në strukturat ushtarake, si dhe kujdeset që personeli të jetë i qëndrueshëm, duke minimizuar ndryshimet e shpeshta të personelit financiar. Personeli financiar, Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve dhe SHPFA kanë caktuar kuotat për personelin financiar në strukturat ushtarake.
- Në masën 4.3, Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve vijoi punën për hartimin gjatë vitit 2024 të draft-rregullores së veçantë për rotacionin e personelit në sektorë sensitivë si prokurimet, duke u kujdesur ta përfshijë atë edhe në rregulloren e brendshme të institucionit.
- Në masën 4.4, në të cilën parashikohet përditësimi i programit të transparencës, sqarojmë se për vitin 2024 programi i transparencës është përditësuar rregullisht me informacionin mbi prokurimet publike.

Në website të MM-së, seksioni “Programi i transparencës” janë të publikuara regjistrat e parashikimit për vitin 2024, si dhe regjistri i realizimit për vitin 2024, të cilat gjenden të publikuara në linkun e institucionit. Këtu përfshihen njoftimet e kontratave, njoftimet e fituesit dhe njoftimet e realizimit të kontratave për procedurat e prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë.

- Në lidhje me masën 4.5, e cila parashikon përditësimin e programit të transparencës në lidhje me kontratat e lidhura, sqarojmë se informacioni mbi kontratat përditësohet rregullisht në faqen e MM-së <https://www.mod.gov.al/politikat-e-sigurise/te-tjera-nga-mm/prokurime>, ku të gjithë personat e interesuar mund të aksesojnë për tu njohur me informacione më të detajuara dhe të dhëna mbi procedurat e prokurimit publik.


Në website të MM-së, seksioni “Prokurime, Ankande”, janë publikuar të dhëna të plota (në përputhje me parashikimet ligjore), për sa i përket prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Kostoja e këtyre masave është administrative dhe e pjesë e planifikimit buxhetor të brendshëm.

Objektivi 5: Politikë e përmirësuar për adresimin e rreziqeve të integritetit në operacione dhe ndërgjegjësim i plotë i të gjitha niveleve drejtuese dhe komanduese të FA-së mbi këto rreziqe.

Ky objektiv përmban tri masa të parashikuara për t'u realizuar nga njësitë e përfshira për vitin 2024, të cilat i referohen dokumentacionit të nevojshëm, me qëllim adresimin e risqeve të korrupsionit në operacione të ndryshme.

Objektivi 5	Masat dhe aktivitetet	Realizimi i masave dhe aktiviteteve			
		Masa të parashikuara dhe plotësisht të realizuara për vitin 2024	Masa të parealizuara për vitin 2024	Aktivitete të parashikuara dhe plotësisht të realizuara për vitin 2024	Aktivitete të parealizuara për vitin 2024
Politikë e përmirësuar për adresimin e rreziqeve të integritetit në operacione dhe ndërgjegjësim i plotë i të gjitha niveleve drejtuese dhe komanduese të FA-së mbi këto rreziqe	Masa/ Aktivitete	3	0	3	



- Për sa i përket detyrimeve të përcaktuara në masën 5.1, mbi hartimin e një dokumenti gjithëpërfshirës, i cili trajton adresimin e risqeve të korrupsionit në operacione brenda vendit, si dhe në operacionet paqeruajtëse dhe misione në nivele strategjike, operacionale dhe taktike, të gjitha këto tematika janë të parashikuara në Planin e Integritetit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-it, i cili mund të gjendet në linkun: <https://www.aaf.mil.al/images/integriteti/2024/SHPFA-pi-290324.pdf>.

- Në lidhje me masën 5.2, hartimi i një rregulloreje për prokurimet në misionet dhe operacionet ndërkombëtare, kjo masë është e realizuar 100% dhe përcaktohet në vendimin nr. 241, të miratuar në datë 20.4.2022, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave që ndiqen për prokurimet e bëra në një vend të tretë, përfshirë prokurimet civile të kryera kur Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë janë dislokuar jashtë territorit të vendit dhe kur, për nevoja operationale, duhet të lidhen kontrata me operatorët ekonomikë, që janë në vendin ku po kryhet operacioni”, i cili ka si objekt përcaktimin e procedurave, që ndiqen për prokurimet e bëra në një vend të tretë, përfshirë prokurimet civile të kryera, kur Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë janë dislokuar jashtë territorit të vendit dhe kur, për nevoja operationale, duhet të lidhen kontrata me operatorët ekonomikë, që janë në vendin ku po kryhet operacioni.
- Në lidhje me masën 5.3, për përfshirjen në dokumentet e politikave të rregullimeve për raportimin e politikës së integritetit në operatione, Ministria e Mbrojtjes është proaktive në kontrollin e politikës së integritetit në operatione. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka njohjen e duhur mbi risqet e integritetit në operatione, përmes Komisionit të Sigurisë.

Kostoja e këtyre masave është administrative dhe e pjesë e planifikimit buxhetor të brendshëm. Këto masa për vitin 2024 janë përmbushur plotësisht në masën 100%.

Konkluzione dhe rekomandime:

Ky raport monitorimi për vitin 2024 është kryer në përputhje me metodologjinë e monitorimit të instrumentit plan integriteti dhe të hartimit të raportit të monitorimit.

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për vitin 2024, të gjetjeve që ky dokument na ofron, të dhënave analitike që drejtoritë kanë raportuar dhe të analizës së kryer, rezulton se:

- Ministria e Mbrojtjes ka vijuar me zbatimin dhe monitorimin e planit të integritetit, duke përmbushur të gjitha detyrimet e parashikuara në këtë dokument;
- Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura është e angazhuar dhe ndjek zbatimin e Planit të Integritetit për Forcat e Armatosura;
- Drejtoritë e ministrisë kanë shënuar përparime kryesisht në forcimin e kapaciteteve të stafit, si në trajnime dhe kualifikime;
- Janë monitoruar strukturat vartëse të MM-së mbi zbatimin e planeve të integritetit;
- Është garantuar transparencë e plotë dhe ofrim i informacioneve mbi aktivitetin e ministrisë për publikun e gjerë, nëpërmjet faqes së internetit www.mod.gov.al;

Hapa të tjerë:

- Të vijohet koordinimi dhe bashkëpunimi me strukturat vartëse të MM-së mbi zbatimin e planeve të integritetit.
- Sektori i Komunikimit Strategjik të marrë masa për përgatitjen e masave dhe aktiviteteve që parashikohet të jenë pjesë e Planit të Integritetit 2026-2028.